



UNIVERSITETI "KADRI ZEKA" GJILAN
"KADRI ZEKA" UNIVERSITY
Zija Shemsiu, 60000, Gjilan, Kosovë
www.upgj.org tel: 0280390112

Ref. nr. 02/261 Dt. 14 / 03 /2014

Në bazëtë nenit 49 pika 1.3 të Statutit të Përkohshëm të Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, Senati i këtij universiteti, sipas propozimit të Fakultetit Ekonomik, në mbledhjen e mbajtur më 26.12.2013 nxorri këtë:

RR E G U L L O R E
PËR STUDIMET THEMELORE – BAÇELOR

I. Dispozitat përgjithshme

Neni 1.

1. Fakulteti Ekonomik është njësi akademike në kuadër të Universitetit "Kadri Zeka" të Gjilanit
2. Fakulteti Ekonomik e ka selinë në Gjilan dhe ofron studime themelore 3 vjeçare (6) semestrare – baçelor.

Neni 2.

1. Studimet themelore bachelor, organizohen dhe mbahen sipas plan-programit mësimor të miratuar nga Këshilli i fakultetit .
2. Plani dhe programi mësimor, mund të ndryshohet apo të plotësohet. Ndryshimet apo plotësimet e plan-programeve mësimore miratohen me propozim të Këshilli të fakultetit

Neni 3

1. Fakulteti organizon studime të rregullta dhe me korespondencë .

Neni 4.

1. Mësimi realizohet përmes ligjeratave, ushtrimeve teorike, ushtrimeve laboratorike, mësimi praktik, seminareve, kolokfiumeve, konsultimeve profesionale, punimeve të pavaruara të studentëve si dhe ekskursioneve me karakter mësimor – shkencor.
2. Lënda mësimore mund të ligjërohet me javë gjatë një apo dy semestrave ose mund të mbahet si bllok ligjeratash në një semestër.

Neni 5.

1. Viti akademik fillon me 1 tetor dhe përfundon me 30 shtator të vitit vijues.
2. Semestri dimëror fillon me 1 tetor dhe përfundon me 15 janar të vitit vijues.
3. Semestri veror fillon me 16 shkurt dhe përfundon me 31 maj të vitit vijues.

2. Kohëzgjatja e studimeve

Neni 6.

Studimet themelore bachelor në këtë fakultet zgjasin katër (3) vjet, përkatësisht (6) semestra dhe kërkojnë që të plotësohen së paku 180 kredi të ECTES-it deri në përfundim të studimeve. Studenti duhet t'i sigurojë për çdo vit të studimeve nga 60 kredi nga provimet e dhëna në lëndët obligative dhe ato zgjedhore.

Neni 7.

Me përfundimin e suksesshëm të këtyre studimeve, studenti fiton thirrjen akademike BACHELOR (BA) për programin, përkatësisht drejtimin mësimor përkatës.

3. Programet e studimeve.

Neni 8

1. Fakulteti i Ekonomik në Gjilan , ofron studime me këto programe- drejtime:

- Banka,financa dhe kontabilitet /Bsc/,
 - Menaxhment dhe informatikë /Bsc/
 - Marketing /Bsc/
- a. Programet e studimit përmbajnë:
- Titullin e studimit;
 - Llojin e studimit;
 - Thirrjen akademike (titullin akademik);
 - Kushtet për regjistrim;
 - Objektivat dhe rezultatet;
 - Hollësitë mbi planprogramin;
 - Kompetencën;
 - Vlera në pikë sipas ECTS (lëndët, punimi i diplomës) etj.

4. Gjuha e studimeve

Neni 9.

- Fakulteti Ekonomik organizon studimet në gjuhën shqipe dhe në gjuhët tjera zyrtare të Kosovës.
- Me vendim të Senatit dhe propozim të këshillit të fakultetit ligjeratat mund të mbahen edhe në gjuhë të tjera.

5. Regjistrimi në vitin e parë të studimeve

Neni 10.

Kandidatët e interesuar për pranim dhe regjistrim në këtë fakultet, duhet t'i plotësojnë këto kushte:

- Të kenë të përfunduar shkollën e mesme dhe të kenë kaluar provimin shtetëror të maturës
- të kenë kryer shkollën e mesme në Republikën e Kosovës (e cila vërtetohet me diplomë),
- të kenë përfunduar me sukses shkollën fillore dhe të mesme më së paku 12 vjet të shkollimit (të vërtetuar me diplomë përkatëse)
- të kenë të nostrifikuar dhe të vërtetuar diplomën e fituar të shkollimit të mesëm jashtë Republikës së Kosovës nga ana e Ministrisë së Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës.

Neni 11.

1. Konkurimi, pranimi dhe regjistrimi i studentëve të ri, bëhet në pajtim me kushtet e parapara me konkurs të cilin e shpallë dhe e publikon Universiteti "Kadri Zeka" Gjilan;
2. Kandidati fiton të drejtën për pranim dhe regjistrim kur e jep provimin pranues me sukses duke u bazuar në numrin e pikëve të fituara sipas ranglistës deri në numrin e përcaktuar për pranim në programin përkatësisht drejtimin përkatës mësimor.
3. Provimi pranues mbahet me test, nëse në konkurs nuk parashifet ndryshe.
4. Kushtet, afatet, organizimi dhe mënyra e mbajtjes së provimit pranues përcaktohen më detajisht në konkursin të cilin e publikon Universiteti "Kadri Zeka" Gjilani.

Neni 12.

1. Kandidati, i cili nuk e ka fituar të drejtën për regjistrim, ka të drejtë të paraqet ankesë, të kërkojë sqarime dhe të shiqoi testin e tij të dorëzuar për vlerësim.
2. Ankesa i paraqitet dekanit të fakultetit në afat prej 24 orësh, nga dita e njoftimit, respektivisht nga dita e publikimit të rezultatit të mbajtjes së provimit pranues.
3. Dekani është i detyruar që ankesat e parashtruara t'i dorëzojë pa vonesë në Komisionin për zgjidhjen e ankesave të formuar nga rektori i Universitetit.

Neni 13.

1. Kandidatët, të cilët konkurojnë në konkurs për pranim, janë të detyruar të paraqesin këto dokumente:

- Aplikimi online përmes web faqes së universitetit
- diploma bashkë me dëftesat e shkollës së mesme (në origjinal)
- certifikata e lindjes,
- kopjen e letërnjoftimit
- pagesën nga banka për provim pranues

2. Dokumentacioni dorëzohet te zyrari për çështje të studentëve brenda afateve të parapara ligjore.

Neni 14.

1. Kandidatët, të cilët e kanë fituar të drejtën për pranim dhe regjistrim, duhet të dorëzojnë pos dokumenteve të cekura më lartë edhe këto dokumente tjera plotësuese:

- Dëftesën e pagesës në emër të regjistrimit të semestrit /shkarkohet nga Web faqja e universitetit/
- Formulari i plotësuar për regjistrim i cili mirret në fakultet.

2. Dokumentacioni plotësues, dorëzohet te zyrari-ja për çështje të studentëve brenda afateve të parapara për këtë qëllim.

6. Statusi i studentit dhe kushtet e regjistrimit të vitit vijues të studimeve.

Neni 15.

1. Studenti regjistrohet në këtë fakultet me status të rregullt dhe me korespondencë, nëse me konkurs për regjistrim nuk parashifet ndryshe.

2. Me rastin e regjistrimit, studentit i lëshohet kartela e identifikimit /ID/.

Neni 16.

1. Regjistrimi në vitin e parë të studimeve bëhet në kohën e përcaktuar me konkurs .

2. Regjistrimi në vitin e dytë dhe të tretë të studimeve, bëhet në kohën prej 1 deri më 15 tetor.

3. Vërtetimi i semestreve bëhet në kohën prej 15 deri më 20 janar (për semestrin dimëror) dhe prej 2 deri me 5 qershor (për semestrin veror).

Neni 17.

1. Studenti i rregullt, është i detyruar që të vijon ligjeratat, ushtrimet, mësimin praktik si dhe t'i kryej të gjitha detyrimet tjera që kanë të bëjnë me vijueshmërinë e mësimin të përditshëm deri në përfundimin e studimeve.

2. Për studimet me korespondencë fakulteti organizon ligjerata dhe konsultime sipas një orari të veçantë.

Neni 18.

1. Studentit i cili nuk është i rregulltë në ligjerata dhe ushtrime, nuk ka të drejtë ta vërtetojë semestrin përkatës dhe as ta regjistron atë vijues.
2. Përbashtimisht, studentit, i lejohet të vërtetoi semestrin përkatës vetëm në raste të veçanta dhe të arsyeshme .
3. Vendimin për këtë e merr dekani.

Neni 19.

1. Studenti ka të drejtë të regjistron vitin e dytë të studimeve, nëse i ka fituar 70% të kredive nga apo provimeve nga numri i përgjithshëm i kredive në lëndët mësimore të vitit të parë të studimeve.
2. Vitin e tretë të studimeve, studenti mund ta regjistron nëse ka fituar 40% të kredive apo provimeve nga numri i përgjithshëm i kredive nga lëndët mësimore të vitit të dytë të studimeve.

Neni 20.

1. Studenti nuk mund të regjistroi vitin vijues pa i dhënë të gjitha provimet e vitit paraprak
2. Studenti, ka të drejtë të përsërisë regjistrimin e vitit të njëjtë të studimeve sa dyfishi i kohëzgjatjes së studimeve

Neni 21.

1. Studenti i cili në afatin e shtatorit nuk i fiton kreditë e parapara me nenin 20 të kësaj rregulloreje, për regjistrimin e vitit vijues, e përsëritë regjistrimin e vitit akademik.
2. Studenti i cili përsëritë regjistrimin e vitit të studimeve, paguan tarifën dhe e shkollimit sikurse studentët tjerë të rregullt respektivisht me korespondencë.
3. Studenti mund të kërkojë edhe njëherë, që t'i vazhdohet kohëzgjatja e studimeve të rregullta për një apo dy vite.
4. Vendimin definitiv për këtë, e merr dekani i njësisë akademike.

Neni 22.

1. Këshilli i fakultetit , ka të drejtë të merr vendime të posaçme për mbajtjen e statusit të studentit të rregullt në këto raste për të arriturat e veçanta të studentit në fushën e arsimit, shkencës, teknologjisë, kulturës dhe sportit.

Neni 23.

1. Studenti mund të kërkojë suspendim të përkohshëm nga statusi i studentit të rregullt në këto raste:
- sëmundje së rëndë,

- kujdesit për fëmijë nën moshën tri vjeçare si dhe
- në rastet tjera të justifikuara.

Neni 24.

Studenti, i cili i ka përfunduar të gjitha provimet e parpara me plan dhe program mësimor për drejtimin përkatës, ka të drejtë të mbajë statusin e studentit të rregullt edhe dy vjet. Gjatë kësaj kohe, studentit duhet t'i përfundojë me sukses të gjitha provimet dhe të jep provimin e diplomës.

Neni 25.

1. Studenti, i cili ka vërtetuar semestrin e gjashtë (6) për herë të parë, gëzon statusin e absolventit.
2. Statusi i absolventit zgjatë një vit. Pas kalimit të kësaj kohe, studentit i cili nuk i ka përfunduar të gjitha provimet me sukses, humbë statusin e absolventit dhe i shtrohet të gjitha obligimeve tjera që vlejné për studentët tjerë (përsëritja e regjistrimit të vitit shkollor, pagesa e regjistrimit etj.).
3. Absolventët nuk paguajnë tarifën e shkollimit.
4. Pas kalimit të afatit prej 12 muaj (statusi i absolventit), studentit paguan tarifën e shkollimit.

Neni 26.

1. Studenti pas jo më tepër se dy vjet ndërprerje, mund të regjistrohet përsëri si student i rregullt dhe mund të vazhdojë në programin e njejtë të studimit që ka qenë valid në kohën e regjistrimit të parë, edhe nëse në ndërkohë është ndryshuar programi i studimit.

Neni 27.

1. Studenti e humb statusin e rregullt në këto raste:
 - kur me dëshirë të vet lëshon studimet,
 - kur ti ketë përfunduar studimet,
 - kur nuk i ka përfunduar studimet në periudhën e dyfishtë të kohëzgjatjes së studimeve.

7. Ndërrimi i drejtimit të studimeve

Neni 28.

1. Studenti ka të drejtë të kërkojë ndërrimin e programit të studimeve në njësinë e njejtë apo në njësinë tjetër akademike të Universitetit.

2. Studentit i lejohet ndërrimi i programit, nëse së paku 50% të provimeve janë dhënë me sukses në programin e mëparshëm e që pranohen në programin e ri të studimeve.

Neni 29.

1. Ndërrimi i drejtimit, lejohet vetëm në kohën prej 15 shtator deri më 30 shtator të vitit vijues.
2. Studentit mund t'i lejohet të regjistrohet në programin e ri të studimeve:
 - në vitin e dytë e tutje të studimeve në programe e drejtime përkatëse mësimore
3. Pëlqimin nga paragrafi 2 i këtij neni, e jep Komisioni për studime, ndërsa vendimin e merr Këshilli i fakultetit.
 1. Ndërrimi i programit të studimit nuk i lejohet studentit i cili duhet sërish të regjistrohet në vitin e parë të studimeve në programin e ri të studimeve.
 2. Kërkesa për ndërrim të programit të studimeve apo drejtimit mësimor, i paraqitet komisionit për studime të këtij fakulteti.
 3. Krahas kërkesës, studenti paraqet edhe certifikatën e provimeve të dhëna të programit të mëparshëm.
 4. Kundër vendimit të komisionit për studime, mund të paraqitet ankesë Këshillit të fakultetit .
 5. Ankesa paraqitet në afatin prej 8 ditësh nga dita e publikimit të vendimit të komisionit.

8. Kalimi nga fakultetet tjera

Neni 30.

1. Studenti i cili është regjistruar në fakultetet tjera, ka të drejtë të bëjë kalimin në njësi tjera akademike nëse i plotëson kushtet sipas nenit 29 në programet (drejtimet) përkatëse.
2. Kalimi lejohet në kohën prej 1 deri më 15 tetor, përkatësisht prej 15 janar deri më 15 shkurt.
3. Nëse kandidatit i lejohet kalimi në drejtimin përkatës atëherë ai-ajo është i obliguar që për çdo provim të pranuar si dhe lejimin e kalimit të paguaj në bazë të Udhëzimit Administrativ të MASHT-it, në llogari të fakultetit-universitetit

9. ORGANIZMIMI I PROVIMEVE

Neni 31.

1. Provimet janë publike.
2. Provimet për studimet themelore mbahen në afatet dhe datat e përcaktuara dhe të publikuara në tabelën e njoftimeve.
3. Afatet e rregullta të provimeve janë:
 - Afatin e Janarit - (që fillon prej 20 janar deri më 15 shkurt).
 - Afatin e qershorit –(që fillon prej 5 qershorit deri më 30 qershor) dhe
 - Afatin e shtatorit – (që fillon prej 1 deri më 30 shtator).

Neni 32.

1. Provimet e publikuara në tabelat e njoftimeve, janë detyruese si për pyetësin ashtu edhe për studentin.
2. Orari i provimeve përcaktohet në atë mënyrë që studenti mos të ketë më shumë se një provim në ditë.

Neni 33

1. Orari i mbajtjes së provimeve, shpallet në fillim të vitit akademik.
2. Dekani përpilon dhe publikon orarin e provimeve, pasi ti ketë marrë më parë datat e mbajtjes së provimeve nga shefat e programeve dhe drejtimeve përkatëse mësimore.
3. Ndryshimi i datës së mbajtjes së provimit, lejohet vetëm në raste të arsyeshme nga dekanati i fakultetit .

Neni 34.

1. Paraqitja e provimeve bëhet:

- | | |
|--------------------------|-----------------------------|
| - për afatin e janarit | - prej 15 deri më 20 janar, |
| - për afatin e qershorit | - prej 1 deri më 5 qershor, |
| - për afatin e shtarotit | - prej 20 deri më 30 gusht |

2. Paraqitja e provimit me vonesë lejohet me vendim të veçantë të dekanit.
3. Paraqitja e provimeve bëhet me ID kartelë përmes sistemit SEMS.

Neni 35.

1. Mësimdhënësi është i detyruar që pas përfundimit të provimit, më së largu brenda 24 orësh t'ia dorëzoi zyrtarit të shërbimit raportin e provimeve bashkë me listën e studentëve si dhe kopjet fizike të fletëparaqitjeve të shkarkuara nga sistemi SEMS

Neni 36.

1. Format e mbajtjes së provimit janë:
 - provimi me shkrim,
 - provimi me gojë,
 - provimi me shkrim dhe me gojë,
 - provimi me test,
 - provimi praktik,
 - kolokfiumi.
2. Provimet e kombinuara me shkrim dhe me gojë, mbahen brenda shtatë ditëve.

Neni 37.

1. Vlerësimi i provimit shprehet me notë:

| | |
|---|-----|
| - nota 10 dhe 9 – shprehë suksesin e shkëlqyeshëm | A,B |
| - nota 8- shumë te mirë | C |
| - nota 7 - shprehë suksesin e mirë | D |

- nota 6 – shprehë suksesin e mjaftueshëm E
- nota 5 – shprehë suksesin e pamjaftueshëm F

Neni 38.

1. Provimet vlerësohen nga një pyetës ose me komision.
2. Provimet me komision mbahen:
 - kur studenti është ankuar në vlerësimin e provimit të mbajtur,
 - kur studenti i shtrohet provimit pas herës së tretë.

Neni 39.

1. Studenti ka të drejtë të parashtrojë ankesë me shkrim – dekanit, kundër notës së marrë në provim si dhe të kërkojë shiqimin e testit të dorezuar dhe të vlerësuar nga pyetësi apo nga Komisioni,
2. Ankesa duhet të parashtrohet brenda 48 orësh, pasi të jenë shpallur rezultatet e mbajtjes së provimit.

Neni 40.

1. Dekani e cakton komisionin prej tre antarësh për mbajtjen e provimit.
2. Në komisionin e caktuar nuk merrë pjesë pyetësi i mëparshëm.
3. Studenti nuk ka të drejtë të paraqet ankesë kundër vlerësimit të komisionit.

Neni 41.

1. Provimi i dhënë në kundërshtim me dispozitat e kësaj rregulloreje anulohet.
2. Vendimin mbi anulimin e provimit e merr dekani.
3. Kundër këtij vendimi, studenti ka të drejtë ankese.
4. Ankesa i paraqitet Këshillit të fakultetit brenda 48 orësh nga dita e njoftimit për këtë.

Neni 42.

- 1 Studenti ka të drejtë të kërkojë shtyerjen e mbajtjes së provimit vetëm në rastet e arsyeshme dhe të justifikuara. Vendimin për këtë e merre Dekani.

a. Të drejtat dhe detyrimet e studentëve

Neni 43.

1. Studentët e pranuar kanë këto të drejta:
 - të marrin pjesë në të gjitha ligjeratat, ushtrime teorike, ushtrime laboratorike, mësim praktik, puna në terren, seminare, diskutime shkencore-mësimore, konsultime profesionale, ekskursione me karakter mësimor – shkencor si dhe në forma të tjera të mësimit që organizohen me plan e program mësimor.
 - të përdorin paisjet e fakultetit sipas rregullave përkatëse për mësim dhe ushtrime mësimore.
 - ta shfrytëzojnë bibliotekën e universitetit në pajtim me rregullat përkatëse mbi punën e bibliotekës.
 - të marrin pjesën e zgjedhjet e studentëve për përfaqësimin e tyre në organet e fakultetit ,

- të marrin pjesë në mbledhjet e organve dhe të komisioneve ku janë caktuar si anëtarë dhe ti kryejnë detyrat e tilla me angazhim dhe përgjegjësi.
- të kërkojnë të njihen me rregullat e përcaktuara mbi studimet themelore në këtë fakultet.

Neni 44

1. Studenti, i cili nuk i përmbahet detyrimeve ligjore, statutore si dhe rregullave dhe obligimeve të parapara me këtë rregullore apo me ndonjë vendim të veçantë të dekanit të fakultetit gjatë tërë kohës së studimeve, bënë shkelje të obligimeve të studimeve dhe për këtë përgjigjet në aspektin disiplinor dhe ligjor.

Neni 45.

1. Studentët kanë të drejtë të ankohen kundër çdo vendimi me të cilin konsiderojnë se iu kanë bërë shkelje e të drejtave të tyre gjatë kohës së studimeve.

3. Ankesa paraqitet:

- kundër vendimit të dekanit, kur ka vendosur si organ i shkallës së parë – Këshillit të fakultetit,
- kundër vendimit të Komisionit për Studime, kur ka vendosur si organi i shkallës së parë – Komisionit për Ankesa të këtij fakulteti,
- kundër vendimit të Këshillit të Fakultetit, kur ka vendosur si organ i shkallës së parë , Komisionit për studime të Universitetit.

a. Organizimi i studentëve

Neni 46.

1. Interesat e studentëve realizohen drejtpërsëdrejti në Këshillin e studentëve dhe përmes përfaqësimit të tyre në:

- Këshillin e studentëve
- Parlamentin e studentëve
- Këshillin e fakultetit dhe
- Senatin e Universitetit

Neni 47

1. Studentët kanë të drejtë të themelojnë organizata studentore, të cilave mund t'i përkasin të gjithë studentët.
2. Këshilli Drejtues i Universitetit xjerrë rregulloren e punës për këshillat e studentëve

b. Përfundimi i studimeve dhe mbrojtja e provimit përfundimtar – (mbrojtja e diplomës)

Neni 48.

1. Studimet themelore 3/tri/ vjeçare – Baçelor në këtë fakultet, përfundojnë pas dhënies së provimit përfundimtar (mbrojtjes së diplomës).

Neni 49.

1. Punimi i diplomës për baçelor punohet individualisht nga studenti duke vërtetuar se aftësitë teorike të arritura gjatë kohës së studimit mund të shfrytëzohen me sukses për zgjidhjen e problemeve praktike në fushat e caktuara shkencore.
2. Procedurat për aplikim, elaborim, mbrojtje dhe vlerësim të punimit të diplomës për baçelor përcaktohet nga këshilli i fakultetit .

Neni 50.

1. Afatet për mbrojtjen e provimit përfundimtar (diplomës) janë:
 - afati i janarit,
 - afati i qershorit,
 - afati i shtatorit,

Neni 51.

1. Mbrojtja e provimit përfundimtar (diplomës), është publike.
2. Mbrojtja e provimit përfundimtar bëhet para komisionit prej tre anëtarësh.
3. Komisionin e cakton dekani në bashkëpunim me shefat e degëve.

Neni 52.

Në provimin përfundimtar (diplomës), studenti duhet të tregojë dituri dhe aftësi teorike që ka arritur gjatë kohës së studimeve, në përvetësimin e temës së dhënë, se temën e ka punuar me metodën që i përgjigjet punimit, se e njihë literaturën dhe dinë ta përdor atë në mënyrë profesionale dhe të pavarur.

Neni 53.

- Provimi përfundimtar paraqet punën e pavarur dhe profesionale të një problemi ose detyrë të caktuar teorike, metodologjike ose profesionale.
- Provimi përfundimtar elaborohet dhe mbrohet individualisht.

-Në raste të veçanta, me vendim të posaçëm të këshillit të fakultetit, mund të lejohet elaborimi i mbrojtjes së provimit përfundimtar bashkë nga dy studentë.

Neni 54.

1. Paraqitja për mbrojtjen e provimit përfundimtar, bëhet në administratën e fakultetit te zytari apo te personi i autorizuar për këtë.
2. Formularët për paraqitje merren në shërbimin e studentëve
3. Formulari plotësohet me të gjitha të dhënat për studentin që paraqitet për mbrojtjen e provimit përfundimtar.
4. Krahas kërkesës për paraqitje të provimit përfundimtar, studenti paraqet edhe:
 - ID kartelën
 - Fletëparaqitjen për provim përfundimtar (merret te referenti për çështje të studentëve)
 - Punimin e diplomës (në katër kopje)

Neni 55.

1. Mbrojtja e provimit përfundimtar (diplomës) mbahet me procesverbal.
2. Procesverbalin e nënshkruajnë anëtarët e komisionit dhe dekani.

Neni 56.

1. Studenti, i cili me sukses e mbron provimin përfundimtar, fiton thirjen BAÇELOR për drejtimin përkatës mësimor.

Neni 57.

1. Studenti, i cili e kryen me sukses provimin përfundimtar, i lëshohet certifikatë në emër të diplomës mbi përfundimin e studimeve 4 vjeçare baçelor të drejtimit gjegjës apo drejtimit gjegjës mësimor dhe diploma origjinale.
2. Formën e certifikatës së diplomës dhe të diplomës origjinalc, e përcakton me vendim të veçantë Universiteti sipas Udhëzimit Administrativ nga Ministria e Arsimit Shkencës dhe Teknologjisë të Republikës së Kosovës.

Neni 58.

Diploma i dorëzohet studentit në mënyrë solemne.

Neni 59.

Administrata e fakultetit mbanë evidencën e studentëve të diplomuar.

10. DISPOZITAT KALIMTARE

Neni 60.

1. Kjo rregullore hynë në fuqi kur e miraton Senati i Universitetit “Kadri Zeka” me propozim të Këshillit të fakultetit .

Neni 61.

Për të gjitha çështjet tjera të cilat nuk janë përfshirë në këtë rregullore, do të zbatohen dispozitat e Statutit të Përkohshëm të Universitetit “Kadri Zeka” të Gjilanit dhe Ligjit mbi Arsimin e Lartë në Kosovë, si dhe aktet e tjera normative.

Neni 62.

Ndryshimet dhe plotësimet e kësaj rregulloreje bëhen në mënyrën në të cilën është miratuar kjo rregullore.



REKTORI

Prof.Ass.Dr. Arben Dërmaku, u.d.